e-Buletini mujor i Sekretariatit për Çështje Evropiane
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Prill 2016

Arbër Ademi oficialisht morri detyrën në resorin eurointegrime nga Fatmir Besimi

Zëvendëskryetari i sapo emëruar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Arbër Ademi sot oficialisht morri detyrën nga paraardhësi i tij Fatmir Besimi. Besimi në dorëzim pranim të detyrës njoftoi Ademin me projektet e ardhshme të Sekretariatit, si dhe me fushëveprimin e punës dhe i dëshiroi të vazhdim të suksesshëm në rrugën drejt integrimeve evropiane të vendit, duke theksuar nevojën e vazhdimësisë në punën për realizimin e qëllimeve strategjike në këtë fushë.
Më shumë

Pjesëmarrja e Zëvendëskryeministrit për Çështje Evropiane Ademi në takim jo formal të Ministrave për Çështje Evropiane në Amsterdam

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi ishte pjesëmarrës në takimin joformal të Këshillit për punë të përgjithshme të ministrave për Çështje Evropiane të BE-së, në organizim të ministrisë për punë të jashtme të Mbretërisë së Holandës z. BertKoenders në funksion si kryesuesit me BE-në. Në darkë u diskutuan zhvillimet e fundit në Bashkimin Evropian.
Një sërë takimesh joformale bilaterale realizoi me kolegët e tij nga Shqipëria Bullgaria, Turqia si dhe përfaqësues të Malit të Zi, Sllovenisë, Kroacisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, shkëmbyen mendime rreth ngjarjeve të fundit aktuale politike në vend, me fokus të veçantë rreth përgatitjes së zgjedhjeve dhe ngjarjeve lidhur me kufirin mes Maqedonisë dhe Greqisë.
Më shumë

Zëvendëskryeministri Ademi për vizitë pune në Republikën e Sllovenisë

Gjatë takimit bashkëbiseduesit iu referuan bashkëpunimit bilateral mes dy vendeve i cili u vlerësua se është në nivel posaçërisht të lartë dhe se të dy vendet kanë partneritet strategjik që karakterizohet me mbështetje të ndërsjellë për procesin e integrimit euroatlantik të Maqedonisë.Gjithashtu u konstatua se ekzistojnë kushte për thellimin e bashkëpunimit të mëtejmë në sferën e marrëdhënieve ekonomike dhe marrëdhënieve tregtare.Lidhur me gjendjen aktuale politike, bashkëbiseduesit potencuan se është shumë e rëndësishme që gjatë periudhës së ardhshme e posaçërisht gjatë ditëve në vijim, të ndërmerren të gjitha aktivitetet e domosdoshme për tejkalimin e gjendjes momentale. Bashkëbiseduesit u dakorduan se Maqedonisë i nevojiten zgjedhje demokratike dhe të besueshme, në drejtim të zgjidhjes politike dhe fokusim i veçantë në implementimin e Reformave Urgjente Prioritare, respektivisht vazhdimësi e rrugëtimit euro - atlantik.
Më shumë

Takime pune

Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Ambasadorin Orav

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi realizoi takimin e parë me shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, Ambasadorin z. AivoOrav. Gjatë takimit, Zëvendëskryeministri Ademi dhe Ambasadori Orav diskutuan për ngjarjet aktuale politike në vend, në veçanti për ngjarjet e ditëve të fundit, ku u theksua rëndësia që në periudhën e ardhshme të ndërmerren hapa në drejtim të përmbushjes së plotë të detyrimeve nga marrëveshja Politike dhe sigurimit të kushteve për realizimin e zgjedhjeve demokratike dhe të besueshme.
Më shumë

Zëvendëskryeministri Ademi realizoi takim me Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës

Gjatë kohës së takimit Zëvendëskryeministri Ademi informoi për pjesëmarrjen e tij në takimin joformal të ministrave të Këshillit për punë të përgjithshme në Amsterdam. Zëvendëskryeministri Ademi dhe ambasadori Plomp, gjithashtu, diskutuan ngjarjet aktuale politike në vend, në veçanti ditët e fundit, gjatë së cilës u theksua rëndësia e periudhës së ardhshme të ndërmerren hapa në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të marrëveshjes politike dhe sigurimi i kushteve për zbatimin e zgjedhjeve demokratike dhe kredibile.
Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për zbatimin e obligimeve të cilat dalin nga Prioritetet Reformuese Urgjente dhe u dakorduan se është e nevojës që në periudhën e ardhshme fokusi të mbahet në aktivitetet të cilët janë kyçë për perspektivën evropiane të vendit.
Më shumë

Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Ambasadoren Oer

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së

Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Ambasadoren e Gjermanisë në Maqedoni z-nja Althauzer

Zëvendëskryeministri i

Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë z. Rakovec

Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi sot realizoi takim pune me Ambasadoren e Republikës së Francës në Republikën e Maqedonisë, SH.S. z-nj LorensOer. Zëvendëskryeministri Ademi dhe Ambasadorja Oer diskutuan për ngjarjet e fundit politike në vend, duke theksuar se përmbushja e detyrimeve nga marrëveshja Politike nga ana e gjithë partive politike pa përjashtim është jashtëzakonisht e rëndësishme për vendin. Zëvendëskryeministri Ademi shprehi mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të cilën Republika e Francës e jep për Republikën e Maqedonisë dhe theksoi se organizimi i Samitit të Parisit, i cili paraqet mundësi të shkëlqyeshme për vazhdimin e bashkëpunimit të vendeve të rajonit, është edhe një konfirmim i kësaj mbështetje. I tillë është edhe angazhimi i Francës dhe qëndrimet e saj për vazhdimin e politikës së zgjerimit me vendete Ballkanit Perëndimor
Më shumë

Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi sot realizoi takim pune me Ambasadoren e Republikës së Gjermanisë në Republikën e Maqedonisë, z-nja KristineAlthauzer. Në takim, Zëvendëskryeministri Ademi dhe Ambasadorja Althauzer diskutuan për krizën politike në vend, duke theksuar se të gjithë nënshkruesit e marrëveshjes politike duhet të plotësojnë detyrimet e tyre për tejkalimin e gjendjes aktuale. Zëvendëskryeministri Ademi shprehu besimin e tij se edhe përkundër gjendjes aktuale, Republika e Maqedonisë vazhdon të mbetet e orientuar kah qëllimi i saj strategjik, integrimi Euro-Atlantik. "Ne duam të bëhemi sa më parë anëtar të NATO-s dhe gjithashtu të fillojmë negociatat për anëtarësim në BE" - theksoi Ademi.
Më shumë

Gjatë takimit bashkëbiseduesit diskutuan për gjendjen aktuale politike në vend, bashkëpunimin bilateral mes dy vendeve si dhe për mbështetjen të cilën vendi jonë e merr nga Republika e Sllovenisë në rrugën e saj të integrimit evropian. Sa i përket ngjarjeve politike në Maqedoni, Zëvendëskryeministri Ademi iu referua ngjarjeve të fundit në vend, i cili ndodhet në gjendje të ndërlikuar politike dhe siguroi se anulimi i takimit të liderëve në Vjenë, i ndërmjetësuar nga Komesioneri Han dhe tre euro deputetët, do të duhet ti shtyjë urgjentisht liderët e partive politike të kërkojnë mënyrë të re për dalje nga kriza dhe rezultate pozitive. Ademi theksoi se duhet të ndiqen postulatet e marrëveshjes politike dhe të organizohen zgjedhje të besueshme dhe gjithëpërfshirëse, të cilat do të njihen nga bashkësia ndërkombëtare.
Më shumë

Takime pune të Sekretares Shtetëror Ana Blazheska

Sekretarja shtetërore në Sekretariatin për Çështje Evropiane Ana Blazheska për vizitë zyrtare në Beograd, Republika e Serbisë

Në kuadër të vizitës së saj Sekretarja shtetërore realizoi takime me TanjaMishçeviq, shefe e ekipit negociues në Republikën e Serbisë me Bashkimin Evropian dhe KsenijaMilenkoviq, Drejtore e Zyrës për Integrime Evropiane të Republikës së Serbisë. Në takime u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit mes dy vendeve si dhe këmbim i informacioneve dhe përvojave në procesin negociues. Marrëdhëniet e mira tradicionale si dhe politika aktive, bashkëpunimi ekonomik dhe sektorial mes Republikës së

Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë, gjithashtu ishin pjesë e bisedave në takimet e realizuara.
Më shumë

Takim i Sekretares Shtetërore me ambasadorin e Republikës së Rumanisë Justinijan Foshka

Takim i sekretares shtetërore Ana Blazheska me Verena Tejlor

Takim me delegacionin e RP Kineze

Prezantim i NPAA revizionit 2016 në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë

Revizioni i NPAA-së për vitin 2006 ka të njëjtin koncept metodologjik të përgatitjes së këtij dokumenti, respektivisht përmbajtja e saj përfshin planet sektoriale për harmonizim të legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së, dinamikën e duhur për përforcimin e institucioneve për implementimin e legjislacionit, si dhe resurseve të domosdoshme për realizimin e rekomandimeve në përputhje me Raportin e KE-së për Maqedoni për vitin 2015 si dhe obligimet e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim - theksoi Ademi.
Më shumë

Prezantim i manualit Procedural për terminologji

Në Klubin e deputetëve u realizua prezantim i manualit Procedural për terminologji. Në prezantim të manualit fjalën hyrëse kishte Sekretarja shtetërore në Sekretariatin për Çështje Evropiane z.nja Ana Blazheska.
Në fjalën e saj z.nja Blazheska iu referua në përmbajtjen, qëllimin si dhe përfitimet nga manuali Procedural për terminologji.
Manuali Procedural terminologjik përfshin terminologjinë në kontekst në përgatitjen e versionit nacional të aquis (e drejta e Bashkimit Evropian) udhëhequr nga ana e Sekretariatit për Çështje Evropiane, e cila është e rëndësisë së veçantë për sigurimin e përkthimeve në përputhje të legjislacionit dhe përpunimit të burimeve të sigurta për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve tanë. E njëjta është e paraparë edhe për përkthyesit, revizorët, terminologët, si dhe të gjithë ata të cilët janë të interesuar për punë terminologjike në përgjithësi. Manuali paraqet përmbledhje të udhëzimeve për përkthim të terminologjisë në Sektorin e përgatitjes së versionit nacional të aquis në kuadër të Sekretariatit për Çështje Evropiane, theksoi Blazheska.
Më shumë

Hyri në fuqi marrëveshja për udhëtim me letrat e njoftimit mes shtetasve të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës

Debat me temë "Kapitalizmi kundrejt Socializmit"

Sekretariati për Çështje Evropiane realizoi ciklin e tretë debatues "BE Yje" në temë: "Kapitalizmi kundrejt Socializmit", në të cilën debatuan studentët e Universitetit ndërkombëtar Ballkanik, në hapësirat e së cilës edhe u realizua e njëjta. Para fillimit të debatit, përpara studentëve fjalën e tyre kishin, Zëvendëskryeministri Dr. Arbër Ademi dhe rektori i Universitetit Prof. dr. IsmailKoxhajusufoglu të cilët theksuan rrolin e debateve në zhvillimin e shoqërive demokratike.
Debati i sotëm ka për qëllim ta ritë interesin dhe diturinë e të rinjve për çështje dhe tema lidhur me BE-në. Me këto debate, SÇE-ja ka qëllim të mundësoj forum të hapur debativ mes të rinjve drejt inkurajimit të mendimit kritik dhe kulturës ku debati shihet si mënyrë demokratike për tejkalimin e dallimeve në mendime.
Më shumë

BE Yjet Debat me temë: "Politikat arsimore: Kualiteti kundër Kuantitetit"

Reforma sektoriale në BE

Komisioni miratoi propozimin nga ana e partnerëve socialë për përmirësimin e kushteve në sektorin e peshkimit, Pas dakordimit të partnerëve socialë për kushtet e punës në sektorin e peshkimit. Komisioni Evropian e kaloi marrëveshjen në një propozim ligjor për një Direktivë. Në vitin 2013, partnerët socialë të BE-së në sektorin e peshkimit arritën marrëveshje, me të cilën u

propozua të harmonizohet legjislacioni i BE-së me Konventën "Punë në Peshkim" në vitin 2007 nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP). Pasi u miratua nga Këshilli, me këtë udhëzim do të zbatohet marrëveshja për partneritet social, e cila parashikon siguri të një niveli më të lartë të mbrojtjes së peshkatarëve në BE.
Më shumë

IPA projekte

"Ndihmë nga BE-ja për forcimin e sundimit të ligjit"

Financuar nga :
Bashkimi Evropian
Qëllimi i projektit:
Mbështetja e institucioneve nga sektori juridik gjatë konsolidimit të sundimit të ligjit duke forcuar kapacitetet e tyre dhe duke ndihmuar për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me Bashkimin Evropian dhe instrumentet kyçe të të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës.
Shuma e përgjithshme: 1 milion Euro
Kohëzgjatja : 21 Muaj (20 dhjetor 2015-19 shtator 2017)
Përfituesi kryesor: Ministria e Drejtësisë, Akademia për gjykatës dhe prokurorë
Më shumë

"Harmonizimi i mëtejshëm me BE-në në fushën e sigurimit dhe rritjes së funksionimit të tregut"

Financuar nga :
Bashkimi Evropian
Qëllimi i projektit:
Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me acquis-në e BE-së në fushën e sigurimit, si dhe përforcimi i kapaciteteve administrative dhe funksionale për plotësimin e standardeve të BE-së në këtë fushë.
Shuma e përgjithshme: 700.000.00 Euro
Kohëzgjatja : 18 Muaj (me fillim nga 05 mars të vitit 2016)
Përfituesi kryesor: Ministria e Financave
Më shumë

"Diversiteti është në trend - Promovim i multikulturës lokal"

Financuar nga:
Bashkimi Evropian
Qëllimi i projektit: ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe ndihmë për përgatitjen e strategjive për përmirësim të dialogut ndërkulturor në komunat e Kumanovës, Strugës dhe Mavrovë-Rostushë, i cili do të paraqet mekanizëm i institucionalizuar për të gjithë palët e interesuar në nivel lokal për përpjekjet e tyre të vazhdueshme për përmirësimin e dialogut ndërkulturor dhe ndëretnik. Projekti do ti mbështes gjithashtu edhe organizatat e shoqërisë civile për implementimin e aktiviteteve të cilat e mbështesin multikulturës të cilat janë në kontekst të mirëkuptimit ndërkulturor.
Shuma e përgjithshme: 277.390,64Euro
Kohëzgjatja : 30 Muaj (janar 2016- 30 qershor 2018)
Përfituesi kryesor: Komunat Kumanovë, Strugë dhe Mavrovë-Rostushë
Më shumë

BE Lajme

- Komisioni Evropian propozon rregulla për transparencë publike tatimore të ndërmarrjeve multinacionale
- Komisioni Evropian emëroi shef të ri në Zyrën e Romës
- Në Evropë u promovua fushatë për mbajtjen e vendit të punës dhe plakje të shëndetshme për të gjithë
- Mbrojtja e konsumatorëve evropianë: lodrat dhe veshjet në krye të listës së produkteve të rrezikshme zbuluar në vitin 2015
- Hynë në fuqi rregulla të reja të BE-së për bashkimin doganor më të thjeshtë, më të shpejtë dhe më të sigurt

A e dini...?

- Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës 2.5 milion njerëz janë të punësuar si punëtorë shtëpiak në BE, nga të cilat 88% janë femra
- 13% e martesave në BE janë "ndërkombëtar" mes çifteve të kombësive të ndryshme, çiftet që jetojnë në vende të ndryshme ose që jetojnë së bashku në një vend tjetër të BE-së
- Në BE, 25% e punëtorëve mendojnë se puna ka ndikim negativ mbi shëndetin e tyre (28% meshkuj dhe 23% femra), dhe 27% mendojnë se nuk do të jenë në gjendje të bëjnë të njëjtën punë deri në moshën 60 vjeçe.

Ditët ndërkombëtare

- 15 Maj dita Ndërkombëtare e Familjes
- 17 Maj dita Botërore e Telekomunikacionit dhe Shoqërisë informatike
- 21 Maj dita Botërore për Diversitetin Kulturor për Zhvillim dhe Dialog
- 22 Maj dita Ndërkombëtare e Diversitetit Biologjik
- 31 Maj dita Botërore kundër Duhanit

Ju falënderojmë!